



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **18.09.2020**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të LMT-së përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratim të Buxhetit për vitin 2021,**
3. **Shqyrtimi i Propozim Rregullores Komunale për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2021,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Rahovecit z. Tomor Kotorri,**
5. **Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,**
6. **Raporti i Performancës komunale janar – dhjetor 2019,**
7. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e vë në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar e KPF-së, konstatohet se në mënyrë unanime është aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratim të Buxhetit për vitin 2021.

Afrim Limani – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Para se të shpjegoj për buxhetin e komunës së Rahovecit për vitin 2021-2023, të ju them se në mes të afatit kohor që ne kemi dërgua raportin në adresat e juaja, ka ndodhur disa ndryshime. Pra në adresë të komunës së Rahovecit si dhe gjitha komunave tjera në nivele të Kosovës ka ardhur qarkorja e tretë buxhetore, ku ka pasur shkurtime buxhetore në të gjitha nivelet e komunës së Kosovës dhe gjithashtu ai shkurtime ka ndodhur edhe në komunën e Rahovecit. Ky shkurtime u bë si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia sepse aktualisht qeveria e Kosovës ka një minus të buxhetit prej 274 milion, atëherë edhe kjo është arsyeja që e kanë paraparë që vitin e ardhshëm ka me pas mungesë të inkasimit të hyrave dhe janë shkua sipas një versionit me shkurtime

buxhetore që komunën tonë vlera e shkurtimeve në total është 332,233 euro. Zvogëlimi i grandit është në shumën prej 236,485 euro, që kemi zvogëlim të grandit të përgjithshëm si dhe zvogëlim të të hyrave vetanake në shumen prej 95,748 euro, që në total i bien 332,233 euro shkurtim i buxhetit në krahasim me qarkoren e dytë buxhetore. Gjithashtu në këtë qarkore janë përcaktuar edhe limitet apo tavanet buxhetore në të gjitha kategoritë edhe ky zvogëlim është sipas qarkores së tretë është kryesisht në investime kapitale. Tani investimet kapitale nuk do të i kemi në shumen prej 4,619,000 por do të kemi në shumen prej 4,086,000 euro, pra krejt ky zvogëlim është në kuadër të investimeve kapitale. Këto janë ndryshimet ne raport me qarkoren e dytë buxhetore të cilën e keni ne adresat e juaja, gjithashtu është edhe një ndryshim tjetër që realisht ne nuk e kemi një konfirmim zyrtar se çka do të veprojmë me grandin e performancës, që po ashtu ju njoftojë se komuna e Rahovecit e ka fituar grandin e performancës që ka dalë si komuna e dytë në nivel të Kosovës, ku shuma e këtij grandit është 550,000 euro dhe tash enigma është që ne nuk e kemi ende një konfirmim që a do të futim në projeksionet e vitit 2021 në kuadër të planifikimit të buxhetit për vitin 2021 apo vlera e cila do të bartet në vitin e ardhshëm por ajo që është me rëndësi se këto kjo shumë e parave janë tonat dhe nëse nuk bëhet këtë vit atëherë vitin e ardhshëm do ta kemi atë grand të përfutur. Atëherë e jona na mbetet që ne duhet me votua këtë grand dhe siç e shihni në aneks se ku kemi paraparë që këto mjete të planifikohen. Nëse nuk kemi një konfirmim zyrtar atëherë sipas analizave tona të drejtorisë për Buxhet dhe Financa, atëherë projektet tona do të i votojmë, përafërsisht me vlera zero që figuron si projekt ndërsa në vitin e ardhshëm mundemi me i alokue ato mjete. Pra këto janë ndryshimet në dallim me qarkoren e dytë buxhetore dhe qarkoren e tretë, dokumenti që është para juve konsideroj që e kemi përgatitë mjaft mirë me detaje me shënime të nevojshme, pra të gjitha shënimet që kanë të bëjnë me buxhetin, që kemi fillua me buxhetin sipas programeve në kategori ekonomike me numër të stafit dhe me të gjitha shënimet e tjera përcjellëse dhe krejt ne fund e kemi listën e projekteve kapitale që konsideroj që në këtë listë janë të përfshira të gjitha kërkesat e qytetareve të cilat i kemi dëgjua që kemi qenë neper debate të ndryshme dhe konsideroj se të gjitha këto janë të përfshira janë të përfshira në investime kapitale, që po ashtu i kemi edhe disa projekte të reja që ndërkohë edhe ju mund të i shihni. Faleminderit

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor rreth informatës që juve ju ka ardhur edhe qarkorja e tretë dhe gjithashtu edhe për informimin që na bëtë sot edhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, unë mendoj se ndoshta kishte me qenë mirë me na dërgua për këtë ndryshim por sido që të jetë sqarimin e keni bërë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin e Komunës, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të LMT-së, mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht e falënderoj drejtorin për paraqitjen e propozim buxhetit për vitin 2021-2023. Unë e kam analizua buxhetin me vëmendje dhe është e vërtetë se ne kemi mbajtur dëgjimet buxhetore si Komitet për Politike dhe Financa edhe në bazë të kërkesave të qytetareve shihet që shumica e kërkesave të qytetarëve janë të përfshira në këtë propozim buxhet. Krahas kësaj desha të them që tani qenka shkurtua edhe buxheti për 332,233 Euro por do të ishte mirë që në mungesë të asaj që nuk na kanë sjellë përmes e-mailit apo fizikisht, do të ishte mirë që për këtë mbledhje ta kishim ndryshimin por tani na tregoi veç drejtori pasi ka ndodhë për të gjitha komunat edhe nuk kemi çfarë të bëjmë, besoj që shuma e performancës e plotëson atë por kjo është diçka që ka ndodhur në të gjitha komunat e Kosovës. Tani unë do të ndalem tek investimet kapitale në përgjithësi kur janë bërë, këtu kemi projekte që janë në vazhdimësi pra që janë vazhdim i viteve të kaluara por kemi edhe projekte të reja siç e tha drejtori, pastaj vërejtjet e mia shkojnë në atë drejtim që disa projekte sikurse edhe vitet e kaluara janë shumë të përgjithësuara edhe ashtu si të përgjithësuara neve si KPF dhe si anëtarë të Kuvendit jemi të painformuar se në fakt se çfarë punë do të kryhet dhe ku do të kryhet pra në cilën pjesë të komunës së Rahovecit pasi ne e dimë se ai projekt do të kryhet diku por vërejtja ime shkon në atë që do ishte mirë që çdo projekte me qenë i detajuar për shkak se vërtetë se drejtorët e të gjitha drejtorive kanë në dispozicion një vit dhe kanë mundësi me i planifikua të gjitha ato projekte kudo që kryhen qoftë në rrugë kanalizim apo diçka tjetër, edhe para Komitetit për Politikë dhe Financa gjegjësisht Kuvendit Komunal me dal vërtetë me një projekt buxhet të detajuar, në mënyrë që ne kur të votojmë me ditë konkretisht edhe me informua edhe qytetarin se kjo punë apo projekt do të kryhet në këtë fshat apo këtë mjedis apo kjo rrugë fushore do të kryhet në këtë vendbanim që me ditë saktësisht, kështu që ka mjaftë

projekte të përgjithësuara edhe unë kisha propozua që këto projekte të përgjithësuara për mbledhjen e Kuvendit Komunal të na vijnë nga të gjitha drejtoritë të vinë të detajuara, pasi në këtë shqetësim e kemi ngritë edhe viteve të kaluara, ndoshta edhe përgjigja do të ishte si çdo herë se këtu nuk kemi vend apo hapësirë apo me çështje kodi. Por unë kam edhe propozim konkret që nëse një projekt është i përgjithshëm, mundet që në po të njëjtin kod me u shkrua në atë fletë ky kod dhe brenda atij kodi do të kryhen punimet në këto vendbanime të caktuara, pra ne ta kemi listën që me ditë që ne atë kodë brenda vitit 2021 do të kryhen këto projekte, pra kodi letë mbetet ashtu siç është por ne me pas projektet e detajuara që me pas mundësi me arsyetua para qytetarëve se brenda këtij kodi do të realizohen këto projekte. Pra propozoj që për mbledhje të kuvendit propozoj që në na ardhë të gjitha kodet e përgjithshme që me na ardhë të detajuara, kuptohet si aneks shtesë të gjitha të shkruara në letër që me pas mundësi me ditë për të gjitha projektet e planifikuara që me qenë të saktë. Përveç kësaj që kodet janë të përgjithësuara, desha me kalua pak edhe te investimet kapitale ku kemi disa kode që nuk ju takojnë investimeve kapitale dhe kjo është një punë e përsëritur që po ndodh nga viti në vit e që kemi dhënë vërejtje edhe viteve të kaluara e që e njëjta gjë është përsëritur edhe sivjet, kështu që ne kemi për detyrë me cekë dhe me tregua që ato nuk janë investime kapitale, konkretisht nëse marrim kodin 46674 Ndërtimi i serrave me participim, shuma 220,000 euro ku konsiderojmë që ky projekt nuk futet në kapitale por hyn në kategorinë e subvencioneve pastaj kemi kodin 47832 Përkrahja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizma bujqësor me shumë 170,000 edhe ky nuk është investim kapital por hyn në kategorinë e subvencioneve pastaj kemi kodin 47865 Stalla dhe ferma të vogla për fermerë me shumë 50,000 euro edhe ky futet në kategorinë e subvencioneve, pastaj kemi kodin 40838 Mbikëqyrja e punimeve me vlerë 30,000 euro ky futet në shërbime, pastaj kemi kodin 40839 Hartimi i projekteve të ndryshme me vlerë 85,000 euro edhe ky futet në shërbime. Pra të gjitha këto ne i vlerësojmë se nuk janë investime kapitale por janë subvencione dhe shërbime. Po ashtu desha tani me bë një formë të pyetjes tek kodi 49909 Vazhdimi i rregullimit dhe rristurimi i shtratit të lumit Rimmnik në Rahovec, Fortesë, Celinë në vazhdim dhe pyetja shkon për drejtorin e shërbimeve publike apo të bujqësisë i cili e përfshin ky projekt pasi e kemi pasur edhe vitin e kaluar. Pra pyetja është se sa është punuar apo investuar vitin e kaluar në këtë projekt së paku deri tash se ndoshta pritët edhe me vonë me u investua diçka deri në fund të vitit dhe e kam dhënë vërejtjen edhe atëherë edhe tani po e jap, pasi emri Celinë që shkruhet si emër në këtë projekt dhe unë mendoj se nuk ka lidhje territoriale e as kadastrale dhe nuk e di arsyen pse shkruhet ashtu kur ska lidhje hiq me fshatin Celinë kështu që kisha dashur sqarime rreth kësaj, pra këto ishin vërejtjet e mia sa i përket propozim buxhetit për vitin 2021.

Fehmi Cena – Përhëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorë të drejtorive dhe gjithë të pranishmit në sallë. Edhe unë me shumë kujdes e kam lexuar plan buxhet për vitin 2021, drejtori për Financa na dha disa sqarime lidhur me disa shkurtime buxhetore në nivel Kosove d.m.th. edhe në nivel të komunës tonë. Natyrisht është për keqardhje kjo mirëpo ne arsyeshmërinë e kuptojmë edhe kjo është në nivel Kosove, besoj që për mbledhjen e ardhshme drejtoria do të na përgatitë materialin komplet me këto ndryshime që sigurisht që do të jenë prej minus 332,000 eurove. Te planifikimi i të hyrave vetanake sa kam mundur me vërejt unë, keni marrë si mostër të hyrat vetanake për 6-mujorin e parë të këtij viti në bazë të programeve nën programeve kodeve dhe nuk e di sa do të jetë reale kjo duke qenë se ne e dimë që kur e kemi shqyrtua buxhetin për të hyrat vetanake për këtë vit për 6-mujorin e parë, e dimë që ka pasur mjaft vërejtje që kanë qenë të arsyeshme dhe ne i kemi arsyetua ato për shkak të pandemisë mirëpo është çështje e juaja megjithatë e pastaj do të shohim se sa do të jetë ajo reale në fund me të hyrat vetanake. Ndërrhyrje më tepër kam tek pjesa e investimeve kapitale, tek shpenzimet kapitale, parafolësi Rasim Fazliu e tha shumicën e gjërave që unë nuk do të doja me i përsëritë por në mënyrë të përgjithësuar do ti them se ajo çka unë mendoj se janë lëshime apo defekte në kuadër të këtij planifikimi, ku shpenzimet nëpër kode buxhetore te shpenzimet kapitale janë të përgjithësuara pothuajse të gjitha pa specifikim të projekteve sikurse u tha, ne do të donim që të kemi specifikim të projekteve edhe nuk është vështirë për drejtoritë, që të njëjtin problem e kemi pasur edhe për buxhetin e këtij viti paraprakisht kur e kemi diskutuar para një viti sepse në këtë mënyrë ne nuk mundemi me i përcjellë ato projekte si realizohen dhe ku do të realizohen por janë të përgjithësuara p.sh. ceket kodi rregullimi i trotuareve në komunën e Rahovecit ose rregullimi i rrugëve në qytetin e Rahovecit, pra duhet të cekën rrugët me emër e mbiemër dhe unë besoj që ato mundemi me i bo. Gjithashtu unë nisem

edhe për vet faktin se unë në këtë Kuvend disa herë e kam cekur rrugën dëshmorët e Pashtrikut se paku 3 herë, për rregullimin e rrugës për trotualet, për disa kanale të kullimit të ujërave atmosferike me të cilën ka probleme shumë kjo lagje por edhe tjera lagje por konkretisht e kam cekur, pasi kemi marrë premtime se do të kryhet dhe qytetarët janë informuar se puna do të kryhet dhe nuk është kryer dhe unë mendoj se arsyeja kryesore që puna nuk është kryer sepse ajo nuk ka qenë e precizuar në plan projekt. Prandaj kërkoj që për mbledhjen e ardhshme, drejtoritë përkatëse me i specifikua projektet me emër dhe mbiemër cilat janë ato që do të kryhen për të cilat do të bëhen shpenzime në kapitale për vitin 2021. Gjithashtu kam vërejtur edhe defektin tjetër, keq klasifikimin e buxhetit që u cekë edhe nga parafolësi, që kemi pasur vërejtje si delegatë edhe vitin e kaluar për këtë vit se kemi keqklasifikim të buxhetit d.m.th. në shpenzimet kapitale përsëri ka shpenzime për mallra dhe shërbime, për subvencione edhe kjo nuk duhet me qenë aty. Pra është defekt që e ka cekur gjithashtu edhe Auditori i jashtëm në mënyrë të përsëritur. Sa i përket orientimit të shpenzimeve tek kapitale, mendoj që shumicën e shpenzimeve është në rregull edhe pse jo plotësisht i drejtë sepse ne si KPF kemi bërë dëgjime publike edhe i kemi parë kërkesat e qytetarëve dhe prioritetet e tyre të ndryshme nëpër vendbanime të ndryshme, si investime në ujin e pijes, në kanalizim janë pak pasi këto unë i marr si prioritet mbi prioritetet edhe komuna duhet të orientohet pikërisht këtu me investua tek uji i pijes, pasi kemi shumë vendbanime që nuk e kanë ujin higjienik të pijes. Edhe te kanalizimi gjithashtu rrjeti i kanalizimit, impiantet, nuk pash asnjë impiant për qytetin e Rahovecit që kemi aq shumë probleme dhe duhet të fillohet me investime në këtë drejtim më tepër pasi këtu është një mungesë apo defekt. Tjetër projekt shtretër shtëpiak të Caritas-it, unë nuk e pashë në këtë projekt buxhet dhe nuk e di se si do të mbulohen ato shpenzime për atë projekt dhe kisha dashur që drejtori me na sqarua se nga cila kategori apo pozicion do të bëhet pagesa e tyre. Tek grandit i performancës, sigurisht që na vjen mirë që komuna jonë është fituese e këtij grandit dhe është një shumë mjaftë e mirë që do ta ndihmon komunën tonë në realizimin e disa projekteve të dobishme për qytetarët, por po e kërkoj një sqarim tek zhvillimi ekonomik që natyrisht të gjitha këto janë projektet pra kodet e reja, Ndërtimi i bujtinave në vendet me potencial turistik, po më intereson se a ka të drejtë komuna me ndërtua bujtina turistike. Për më tepër rreth këtij plan buxheti nuk kisha hy në detaje dhe unë mendoj që drejtori e ka kuptuar atë që ne po kërkojmë dhe janë pothuajse kërkesat e njëjta që i kemi shtruar edhe në të kaluarën edhe u sqarua paraprakisht hollësisht se nuk dua me hy në kode dhe kisha dashur që këto ndryshime vërtet me u bo, në mënyrë që ne ta kuptojmë buxhetin më mirë dhe drejtë.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, nënkryetar dhe gjithë ju të pranishëm. Me te vërtetë kur të tjerët flasin më përpara problematikat janë të ngjashme që i vërejmë ne nga materiali i punës, kështu që shumëçka u tha me shumë të drejtë që duhet të ketë përmirësime me sqarime bashkëpunim për projektbuxhetin për vitin 2021 dhe natyrisht që kam edhe unë disa vërejtje shtesë përpos këtyre që u thanë me herët edhe unë pajtohem me to por megjithatë unë kam një dobësi në të pamur pasi nuk i shoh kodet mirë edhe është mirë që tjera herë ta rritni faqen sepse kjo me të vërtetë është shumë e vogël dhe duhet t'i rritni sepse vërtet nuk vërehen. Pra ne i kemi pasur disa dëgjime publike nëpër fshatra dhe nëpër lagje të qytetit dhe kemi pasur kërkesat e tyre para vetit mirëpo megjithatë ka një numër të madh të kërkesave që qytetarët kanë nevoja për to por nuk janë të paraqitura në projekt buxhet, kështu që unë kësaj radhe nuk do të dal konkretisht me propozim edhe të disa projekteve tjera që do të duhet të hasim mirëkuptim ne bashkë këtu sepse unë si përfaqësues i qytetarëve drejtpërdrejt i lidhur me ata sigurisht që kam edhe nevojat dhe kërkesat e tyre me i transmetua te ju. Mirëpo disa sqarime të vogla për mbledhjen tjetër do ti kërkoj por paraprakisht kisha kërkuar që fondi i performances është mirë të rishqyrtohet edhe njëherë dhe të bëhet një shpërndarje mundësisht nëse na jepen paratë për këtë vite për këtë projektbuxhete 2021 që të bëhet një shpërndarje e re sepse kemi disa nevoja që me te vërtet është e nevojshme që të intervenohet përmes kuvendit komunal. Në faqe 6 e kemi çështjen e ashensorit dhe dua një sqarim, se çfarë ashensori do të bëhet ky që duhet me mbërri deri ne vitin 2023 me u ndërtua ashensori në kuvendin komunal i cili është i domosdoshëm për një kategori të qytetareve jo që nuk e kemi, te performanca kemi pasur të theksuar që kemi mungesën e përqindjes së punësimit të tyre edhe mungesën e çasjes se tyre për me pas në administratën e juaj naltë d.m.th. duhet 3-4 vjet për me u bo një ashensor i thjesht i cili nuk kushton më shumë se 15,000 euro dhe tash qytetarët e kësaj kategorie duhet me pritë që ai ashensor me ju dhanë mundësinë me pas çasjen atje. Prandaj edhe unë e kam këtë vërejtje që kjo duhet me u krye edhe vitin e kaluar kemi folur për këtë ashensor por megjithatë prapë nuk është bërë asgjë. E kemi

pastaj projektet me donatorë që vërtet nuk po e kuptoj se ka janë këto projekte me donatorë dhe a kish pas mundësi drejtor të na sqaroni. Pastaj kemi krijimin e parkingjeve, një dukuri e projektbuxheteve të qeverisjes tuaj si kanalizime ujësjellës rrugë parkingje e shumëçka tjetër, që të gjitha pa projekte. Paraprakisht duhet të theksohet projekti p.sh. i kanalizimit siç e tha edhe kolegu Rasim Fazliu se në këtë vend do të bëhet kanalizimi dhe kjo është shuma që do të investohet, sigurisht që jam në dijeni që mirëmbajtja e rrugëve, kanalizimeve, ndriçimit publik sigurisht që duhet të mirëmbahen dhe duhet të ndahen mjete për riparimin e tyre por të ndërtohet diçka e re atëherë duhet me pas projektin dhe duhet të ndahen mjete strikte sepse me këto gjëra nuk duhet me u manipulua në këtë formë dhe mendoj se nuk është aspak profesionale dhe e drejtë kjo punë. Përpos kësaj nuk e di se ku do krijohen këto parkingje pastaj kemi ndërtimin e semaforëve, nuk e di se kur do bëhen ata semafora dhe sa do të kushtojnë ky projekte i vendosjes së semaforëve. Pastaj në faqe 7, kemi ndërtimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik, kanalizimi, kanali i kullimit të tokave bujqësore që të gjitha janë bashkë dhe nuk dimë destinimin e tyre si projekte pasi nuk kemi informacioneve sa i përket këtyre projekteve prandaj është mirë që të sqarohen këto. Po ashtu jam i interesuar me ditë edhe ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit, pasi ka dy vite që vazhdimisht investohet dhe nuk e di a keni projekt për këtë pasi aty është një vend që për 3 ditë organizohet Hardh Fest pastaj thuani se do të behet një treg që përmbi dhe nuk e dimë se çka do të behet tjetër aty dhe neve si kuvendarë na duhet projekti që me pa dhe me ju tregua qytetarëve se do të bëhet kjo punë aty. Përpos kësaj kemi edhe ndërtimin e shtëpisë së verës, ne duhet ta dimë se çka me te vërtetë do të bëhet aty dhe duhet ta kemi një projekt që me ditë. Pastaj kemi ndërtimi e rrjeteve antibreshër edhe këtë kam dëshirë me sqarua se çka është me të vërtetë kjo, se ku përdoret, kush e përfiton këtë do të ishte mirë me ditë. Pastaj në faqe 8, kemi ndërtimi i muraleve, edhe për këtë është mirë të sqarohet se çka është kjo dhe a është ndërtimi i muraleve se a kemi ndarë mjete për projekt apo për ndërtim, pasi së pari duhet me pas një projekt që me pas një pasqyrë se për çka e kemi fjalën me bo e krejt masandej me bo. Pra po dua me ditë që a janë të gatshme projektet dhe duam veç me i implementua apo është e kundërta. Edhe kësaj radhe drejtori i arsimit nuk qenka prezent dhe ajo çka dua të them se është janë ndarë shumë pak sa i përket teknologjisë informative nëpër shkolla ku kemi mbi 30 shkolla edhe i kemi ndarë gjithsej mbi 8000 euro, që unë mendoj se është pak po ashtu edhe për pajisjet me mjete konkretizuese që ndoshta janë futur edhe kabinetet, prandaj është mirë të sqarohen pse janë ndarë kaq pak mjete.

Afrim Limani - Faleminderit kryesues, unë prita që po ma uroni për grandin e performancës, por edhe për ju urime që jemi dalë komuna e dytë në nivel të Kosovës, në shumën 550,000 euro. Pyetja që parashtrij me herët Dervish Çadraku se faqet janë shumë të zvogëluara mirëpo dua të them se për shkak të shume shënimeve dhe shtyllave të vogla atëherë po kufizohet faqja por gjithsesi për Kuvend do të shohim mundësinë që me zgjerua. Mesuesi Rasim Fazliu i beri disa pyetje dhe një prej tyre ishte se disa projekte ishin të përgjithësuara që ju mungojnë shënimet përkatëse në kuadër të projekteve. Ne kemi diskutuara edhe disa herë të tjera edhe prape po e them që për shkak të sistemit Pip, ne nuk mundemi me i futë të gjitha të dhënat në kuadër të një projekti mirëpo për këtë ju garantoj se drejtori i drejtorisë përkatëse i ka të gjitha shënimet, po supozojmë ndërtimi i kanalizimeve dhe drejtori i ka shënimet në cilindo vendbanim ka me u investue dhe sa është paramasa për ato investime edhe këtë mund ta shihni edhe ju vetë pasi ishte edhe kërkesë e juaja. Pyetja tjetër ishte se janë disa kode që nuk i përkasin investimeve kapitale, kjo pyetje gati nga të gjithë ju është parashtruar edhe në çdo vite është përcjellë kjo. Mirëpo unë mund të ju them se që nga viti 2020 pra në këtë vit që jemi aktualisht kur e kemi bo planifikimin e buxhetit vitin e kaluar për vitin 2020, unë kam deklaruar se nuk do të kemi keq klasifikime pasi kam marr një përgjegjësi morale që nuk do të ketë dhe po ashtu edhe kjo listë e projekteve kapitale nuk do të ketë keq klasifikime, edhe atë që ju e thatë mesues edhe unë kam dyshuar mirëpo është një rregullore e cila thotë që çdo investim që kalon vlerën mbi 1000 euro dhe afatgjatësinë e ka mbi një vit atëherë ajo trajtohet si investim kapital. Në si komunë e kemi edhe një përparësi tjetër pasi me çdo fermer kemi një kontratë 5-vjeqare pasi një pajisje nuk mund ta përvetësoj brenda 5 viteve kështu që edhe vitin 2021 dhe 2022 ju garantoj që nuk do të ketë keq klasifikime. Rregullimi i shtratit të lumit Rimnik ishte pyetja dhe si është gjendja e këtij projekti. Informatat që posedoj ndoshta janë të pamjaftueshme por për mbledhjen e radhës që do ta kemi në Kuvend, drejtori do të jep shënime me të gjëra dhe më konkrete. Pastaj doktori bëri disa pyetje, që njëra nga pyetjet ishte planifikimi joreal i të hyrave vetanake. Këtë pyetje e keni bërë edhe vitin e kaluar edhe konsideroj se e kam marr parasysh dhe i kam

pranuar disa vërejtje që i kanë dhënë edhe për vitin 2020 edhe konsideroj që të hyrat sipas kodeve ekonomike deri në këtë periudhë janë duke shkuar shumë mirë sipas programeve që i kemi bërë planifikimin. Mirëpo ne si komunë e Rahovecit që kam deklaruar edhe me herët edhe e them edhe tani që vazhdimisht kemi bërë kërkesë në Ministri të Financave që limitet e të hyrave vetanake të rrisim edhe me shume sepse jemi të sigurt që kemi me arrit atë dhe ata nuk e kanë bërë dhe bile kësaj radhe me qarkoren e tretë buxhetore edhe na kanë zvogëluar për 95,000 euro, atëherë deri sa të bëhet ky zvogëlim do ta kemi edhe problem të planifikimit që me në mënyrë të saktë dhe kështu duhet me bo mbi limitin e lejuar. Pastaj pyetja ishte orientimi i planifikimit të buxhetit jo sipas kërkesave, që unë konsideroj që buxheti është bërë në masë e planifikimit shume të mirë dhe konsideroj që të gjitha kërkesat të cilat janë paraqit qytetareve janë të inkuorpuara në këtë liste të projekteve kapitale. Në çështja e ujit të pijes, drejtorin e shërbimeve publike e kemi këtu, edhe me sa e di komuna e Rahovecit e ka zgjidhur problemin e ujit të pijes për të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit dhe tash ka ngelur vetëm çështja e përmirësimit apo e zgjerimit të disa segmenteve në kuadër të disa vendbanimeve të ndryshme. Dhe unë konsideroj që çështja e ujit të pijes në gjithë komunën e Rahovecit është e rregulluar, që i kemi pasur dy fshatra pra Pastasel dhe Baboc dhe brenda këtij mandati janë krye edhe këto dy fshatra. Pastaj planifikimi i shërbimeve të veçanta në kuadër të shëndetësisë, që për me ju ikë keq klasifikimeve pasi veç kemi pasur keq klasifikime dhe këto janë të planifikuara në kuadër të kategorisë mallra dhe shërbime dhe shumica e buxhetit është në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë edhe një pjesë tjetër në Financa edhe në drejtori tjetra, kështu që ne e kemi mundësitë buxhetore me i mbulua këtë projekte. Pastaj Dervishi bëri disa pyetje dhe njëra prej tyre ishte tek projekti i performancës që ne i kemi qitë dhe mund të themi që ato projekte janë shume mirë të planifikuara me analiza dhe detaje edhe konsideroj që janë të qëlluara dhe ju si asamblistë mundeni me i dhanë vërejtjet e tua edhe me dhanë edhe ndonjë propozim por mund të ju them që ato janë të planifikuara shume mirë dhe të analizuar sepse nuk kemi bërë ad hoc por planifikimi ka ekzistuar edhe me herët, pra kemi pasur nevojë për ato projekte mirëpo ne mungesë të buxhetit i kemi dhënë prioritet disa projekteve tjera. Po ashtu edhe projekti i ashensorit u bo problem kjo çështje që realisht ka mbi 4 muaj që kemi aplikua me një organizatë dhe kemi premtime që brenda këtij viti fiskal do të na mbështesin për ashensor dhe po shpresojmë se do të kryhet edhe çështja e ashensorit por për siguri e kemi lanë si kodë që ta kemi edhe vitin e ardhshëm pasi nëse nuk e kemi si kodë atëherë mund të na krijohen edhe probleme tjera dhe po konsideroj që nëse nuk bëhet deri në fund të këtij viti atëherë në fillim të vitit të ardhshëm do ta kemi ashensorin. Pyetja tjetër ishte rreth projektit me donatorë, që zakonisht ky projekt është i planifikuar në kuadër të drejtorisë për Financa dhe Buxhet pasi kjo drejtori ju jep parë drejtorive tjera dhe fjala është kryesisht për ato projekte të cilat ne mundemi të i përvetësojmë nga organizatat e ndryshme apo nga Ministria sepse është si rregull paraprakisht se në momentin kur e kemi fitua një projekt është e caktuar edhe shumat në përqindje që po supozojmë 80% donatori edhe 20% komuna kështu këtë pjesën 20% duhet ne me financua edhe është e planifikuar në kuadër të drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Pastaj ishte pyetje e ndërtimit rreth infrastrukturës së tregut të rrushit që për këtë projekt informatat me të mira mundet me ju dhanë drejtori i drejtorisë përkatëse pasi informacionet e mia janë të pamjaftueshme apo gjysmake ndërsa të ndërtimi i shtëpisë së verës, këtu drejtori ka parapare që me i bo disa investime të vogla aty sepse ka fillua me u demolua ai objekt edhe vlera nuk mundet me qenë me shume se 5000 euro por është projekt kapital dhe duhet të figuroj në listën e projekteve kapitale. Ndërtimi i muraleve, këtu e kemi drejtoreshën për Kulturë edhe sigurisht që mundet të ju jep përgjigje adekuate dhe sqarime rreth këtij projekti. Pyetja tjetër ishte në Arsim, projekte pa mjete të konkretizimit dhe siç e dini arsimi më se shumti na ka marr mjete për investime kapitale sepse i kemi 3 shkolla edhe 5 çerdhe për fëmijë dhe konsideroj se me buxhetin e vitit 2021 i mbyllim kontratat me përjashtim që mundet me na mbet edhe shkolla në Fortesë dhe me këtë qellim kemi lanë pak mjete në kuadër të këtij projekti me mundësinë që këtu zakonisht ka donacione të shumta edhe shpresojmë që edhe ato mund të i përfitojmë.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë juve dhe për kontributin e juaj për buxhetin fjala ishte për krijimin e parkingjeve të reja, të palestra është krijuar një hapësirë për parkingje të reja. Unë jam në diskutim edhe me drejtorinë e përgjithshme të PTK-së të objekti i Postes dhe hapësira që është aty pranë objektit të postes të krijohet si parking. Jemi në diskutim me ata dhe besoj që shumë shpejt do të dakordohemi që të krijojmë një parking aty. Pastaj për projektin e semaforëve presim që sot të nënshkruhet

kontrata për semaforët dhe vendi të semaforët ekzistues që janë pastaj të QKMF dhe tek shkolla profesionale, pra këto janë vendet që mendojmë me u vendos semaforët. Sot nënshkruhet kontratë e re e semaforëve, siç e dini më herët kemi pasur probleme pasi kontrata ka qenë e nënshkruar mirëpo operatori ka qenë i papërgjegjshëm edhe ai operator është futur në listën e zezë dhe çështja është proceduralisht në gjykatë që ne kërkojmë kompensim kështu që sot presim me u nënshkrua kontrata e re dhe shume shpejtë që të filloj ky projekt dhe të realizohet brenda këtij viti.

Fehmi Cena – Mendoj që drejtoresha i mbeti borxh Dervish Çadrakut sa i përket projektit për muralet mirëpo kur ta merr fjalën unë po kërkoj edhe një sqarim prej saj, që është kodi 49953 Ndërtimi i qendrës rinore dhe të kulturës në Rahovec, me na shpjegua më gjerësisht se a është fjala për objektin e ri pasi që ndërtim do të thotë objekt që do të ndërtohet apo renovimi i objektit ekzistues. Prandaj është shumë e rëndësishme që po themi se me pas projektin që me pa se ku është dhe çfarë është, që me i pas gjërat e qarta e jo siç shkruhet vetëm ndërtimi i objektit dhe nuk po dimë se çka është ky projekt, kështu që le të na sqaron drejtoresha me gjerësisht rreth kësaj.

Bjondina Kleqka – Sa i përket kodit 49953 Ndërtimi i muraleve dhe veprave tjera përmes artit, është një kod që kemi planifikua në ndërtim e që faktikisht është investim në murale përmes ngjyrave dhe veprave tjera mirëpo për shkak të sistemit është emërtua edhe si ndërtim që kryesisht është në vepra që planifikon dhe identifikon qytetin e komunës së Rahovecit. Ndërsa sa i përket kodit Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec, kryesisht është ndërtimi i një qendre inovative multifunksionale ku për këtë kod kemi bo kërkesa të vazhdueshme në Ministri dhe kërkojmë përkrahjen e tyre që të kemi një qendër e cila përfaqëson të gjitha aktivitetet që mund të zhvillohen më inovative. Sa i përket projektit nuk kemi ende projekt por është vetëm si kod ndërsa në momentin që do të kemi ndonjë investim atëherë do të planifikohet edhe projekti.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtoreshë, atëherë të nderuar kolegë, konsideroj që të gjithë kemi dhënë kontributin rreth kësaj pike dhe mund të konstatojmë se kalon për Kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Tani jemi në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim Rregullore komunale për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2021.

Afrim Limani – Rregullorja e tatimit mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021, ajo çka kërkohet nga ju sot që të i referohemi faqes së fundit ku e kemi shkallën tatimore apo koeficientet tatimor që ju duhet ta votoni dhe sa për dijeninë tuaj këta koeficient në komunën e Rahovecit janë me të ulët në nivele Kosovë, pra kufiri me i ulët që kemi 0,16% ndërsa për njësitë komerciale të parcelave kemi 0,17% dhe këta koeficiente me poshtë nuk mundën me shkua ndërsa më lartë mundën me shkua deri në 1 dhe tash ju jeni ata të cilët duhet ta votoni nëse doni me ngritë apo jo. Mirëpo sipas procedurave ligjore kjo rregullore duhet kaloj edhe përmes kuvendit. Këtu janë të përfshira të gjitha zonat, që i kemi 6 zona në krahasim me rregulloren e vjetër që e kemi pasur dhe në momentin kur ka hy aplikimi i tatimit në toka dhe në parcela atëherë ka ndryshuar edhe kjo rregullore.

Rasim Fazliu – Në këtë propozim rregullore mbi tatimin e pronës së paluajtshme për vitin që na prezantoj drejtori, unë desha të ndalem kryesisht në disa lëshime, ku thuhet në propozim rregulloren në tatimin e pronës së paluajtshme për vitin 2021. Do të ndalem tek neni 1, Objekti i rregullimit, ku në këtë rregullore përcaktohet norma tatimore për vitin 2019 dhe ne po flasim për një propozim rregullore për vitin 2021 kurse këtu shkruan për vitin 2019. A është ndonjë gabim dhe duhet me u përmirësuar dhe tek neni 2, zonat tatimore gjithashtu këtu thuhet për vitin 2020 zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për metër katror në komunën e Rahovecit caktohen si vijon, pra edhe këtu duhet me qenë 2021 sepse është viti 2020. Pastaj desha të kaloj në faqen tjetër, tek pronat komerciale ku është një lëshim në shkrim ku thuhet shitore, zyrë, restorante, hotele. Po ashtu desha të ndalem te zonat p.sh. të marrim zonën e katërt, ku thotë emri i zonës së vlerës që realisht është fjali shumë e pakuptimtë pastaj Xërxe, Bellacerk, Bernjakë, Krushë e Vogël dhe nuk e kuptoj pse figuron emri Krushë e Vogël këtu dhe është mirë këto gjëra me u përmirësuar pasi këto janë dokumente dhe duhet të mbeten të shkruara ashtu si duhet, pastaj përkufizimi i zonave siç e cek në zonën e katërt edhe në zona tjera pasi unë e di që në letrat e mëparshme që na kanë ardh te përkufizimi i zonave kanë qenë me mirë të adresuara, pasi thotë zona e parë përfshin këto vendbanime dhe e cek saktësisht pastaj zona e dytë këto vendbanime saktësisht ishin të cekura vendbanimet. Kurse këtu ka shumë lëshime dhe gabime në

përkufizimin e zonave dhe kisha pas dëshirë që për mbledhje të Kuvendit të evitohen këto lëshime dhe gabime dhe të vjen dokumenti në mënyrë të rregullt pa këto lëshime.

Florida Bajraktari – Te kjo rregullore mbi pronën e paluajtshme për vitin 2021, mendoj se ka qenë mirë me na tregua se cili është ndryshimi i kësaj rregullore me rregulloren e kaluar. Mendoj se u deshtë me u cekë ato ndryshime që me ditë konkretisht se cilat kanë qenë ato pasi që tani po duamë me votua apo me miratua një rregullore të re.

Fehmi Cena – Kur jemi te kjo pikë e rendit e ditës, pra te kjo rregullore mbi tatimin në pronën e paluajtshme po dua një sqarim tek faqja 4, njesitë e objekteve bujqësore – zona tatimore kullosë, livadh, pemishte, vreshtë, pasi deri më tash nuk ka pasur tatime në parcela dhe tokë por vetëm në objekte, a do të fillojë tatimi apo kjo është formalisht vetëm sa ta kemi rregulloren dhe pastaj pritet vendimi shtesë dhe dua të di si qëndron puna.

Afrim Limani – I nderuari mësues Rasim Fazliu, faleminderit shume për vërejtjet që i keni dhanë dhe të gjitha i pranojë por sinjerisht dua të ju them se nuk kam pasur kohë të merrem me rregullore sepse këto ishin të njohura për mua dhe nuk jam fokusua tepër pasi me tepër jam marr me buxhet pasi me ka marr shume kohë dhe të gjitha i pranojë dhe shpresoj që për mbledhje të kuvendit do ta kemi rregulloren e përmirësuar. Pastaj Florida Bajraktari pyeti rreth ndryshimit të rregullores se re dhe të vjetër, që realisht rregullorja e vjetër është e inkorporuar në rregulloren e re sepse para kësaj rregullore objekt i tatimit kanë qenë vetëm pronat pra objektet kurse tani kemi fillua aplikimin e tatimit përpos në objekte është edhe ne prona rezidenciale e të gjitha kategorive si pjesa e oborrit neper shtëpia pastaj në prona komerciale industriale dhe të gjitha. Tjetër ndryshim është se ka fillua se aplikuari tatimi në te gjitha kategoritë e parcelave mirëpo deri ne këtë vite që jemi tani jo ndoshta në vitin 2021 fillon tatimi në tokë pasi departamenti i tatimit në pronë me Ministrinë e Bujqësisë kanë disa probleme mirëpo tatimi në tokë nuk është i llogaritur me përjashtim në male pra nuk është as në kullosa livadhe toka bujqësore djerrina pra të gjitha këto nuk është. Pra aktualisht tatimi aplikohet zbatohet vetëm në prona rezidenciale oborre që janë edhe ne male, pra kjo është ndryshimi. Po ashtu pyetja tjetër ishte se pse janë krijuar kaq zona. Në vitin 2015-2016 në kuadër të tatimit në pronë është një projekt i madhe në gjithë Kosovën ku kanë punuar disa ekiye e konkretisht edhe në komunën tonë për mbi 3 muaj në vitin 2015-16 edhe ky ekip ka dalë ne terren dhe ka bërë intervistime pastaj ne gjykatë ka marr shënime dhe po ashtu shënime të përmbaruesi. Kështu që mbi bazën e tyre janë krijuar edhe zonat, po supozojmë çmimi i një toke bujqësore p.sh. në fshatin Mraor dhe çmimi i njëjtë ka rezultue të jetë edhe ne Retijë atëherë edhe zona është përkufizua në bazë të këtyre të dhënave dhe krejt këto janë krijuar në gjashtë zona. Pra edhe kjo ishte një informatë që ta keni parasysh dhe ne si drejtori e Financave kemi vërejtje në kuadër të këtyre zonave sepse vetëm qytetari i Rahovecit ndahet ne 3 zona edhe me kufijtë shume të përafërt edhe ka ndryshim nga çmimi. Ne kemi të paraqiture edhe tabelat që sigurisht në mbledhje të Kuvendit do të shihni dhe ne kemi adresua vërejtjet dhe kërkesat tona, shpresoj që edhe komunat tjera e kanë bërë këtë edhe sigurisht që në një të ardhëm të afërt edhe ndryshime të këtyre zonave me çmime.

Rasim Fazliu – Unë konkretisht po të pyes për normat tatimore dhe dua të di se çka ndryshojnë normat tatimore të kësaj propozim rregullore nga rregullorja e deritashme, a ndryshojnë apo janë të njëjta, pra për normat tatimore konkretisht po pyes.

Afrim Limani - Për t'i ndjekur procedurat ligjore edhe ne këtë rregullore duhet me qit në Kuvend edhe duhet të votohet nga Kuvendi, siç e thash se këto norma janë kufiri me i ulët dhe ndër normat më të vogla në nivele të Kosovës. Tash ne këto norma që i kemi 0,16% mund t'i rrisim deri ne 1% dhe me rritjen e këtyre normave tatimore kuptohet se rritet edhe tatimi sepse tatimi shumëzohet me metër katror dhe shkalla tatimore plus koeficienti dhe e jep vlerën. Pra nëse ju doni me rritë tatimin në pronë edhe në parcela atëherë ju mund t'i ngritni edhe këto koeficientë.

Dervish Çadraku – Si e shpjegoni drejtor këtë kur në të njëjtën zone qëndron edhe Çifllaku edhe Malësia edhe Sapniqi edhe Bratatini, kur dihet si Çifllaku dhe Malësia janë ne rrugën regjionale kurse Sapniqi edhe Bratatini janë zona tjera, pra pse të gjitha në zonën e katërt.

Afrim Limani – Sipas llojit të tatimit, te tokat bujqësore p.sh. kemi toka bujqësore industriale edhe komerciale. Po supozojmë në Malësi të Vogël janë shkua personat edhe kanë bërë anketimin p.sh. 1 hektar ka kushtua 1000 euro po ashtu janë shkua edhe ne fshatin Çifllak edhe ka dal i njëjti çmim ashtu edhe në fshatin

Bratatin dhe ne baze të këtyre shënimeve edhe rezultati i intervistës që kanë marr neper këto zona dhe i kanë vërtetua te përmbartuesi se sa ka qenë shitblerja 1 ari p.sh. ne Malësi të Vogël edhe janë përputhë shënimet dhe në bazë të këtyre dhënave janë krijuar edhe zonat.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, të nderuar kolegë kuvendarë faleminderit për kontributin tuaj, atëherë konstatojmë se kalon për kuvend edhe e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Rahovecit z. Tomor Kotorri.

Bjondina Kleqka – Para jush e gjeni propozimin e kryetarit të Komunës për shpalljen qytetar nderi z. Tomor Kotorri. Duke marr parasysh veprimtarinë e tij në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kombëtare shqiptare për kultivimin e frymës atdhetare vëllazërore ndërmjet Bashkisë së Përmetit dhe komunave tjera jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe për kontributin atdhetar si dhe në kontributin e dhënë në binjakëzimin konkretisht vëllazërimin të Bashkisë së Përmetit me Komunën e Rahovecit dhe për bashkëpunim vëllazëror, konsiderojmë si propozim adekuat për miratim të vendimit të kryetarit për shpallje qytetar nderi. Për me shumë detaje e gjeni edhe biografinë e tij dhe duke miratuar këtë propozim, ne kontribuojmë në vlerat e frymës atdhetare, bashkëpunimit vëllazërore si dhe motivimin e veprimtarisë nga viset e ndryshme shqiptare për zgjerimin e komunikimit ndër shqiptar nga të gjitha hapësirat ku jetojnë e punojnë shqiptaret. Atëherë me propozimin e kryetarit të komunës, ne shpresojmë edhe miratimin e kuvendit komunal për të kaluar kjo pikë për në Kuvendë.

Fahrie Lushi – I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit, sa për ti dhënë shtytje dhe pak modesti kësaj kërkesë që vjen nga kryetari. Meqë komunat gëzojnë binjakëzimin që nga 2017-ta dhe flet më së miri edhe biografia e z. Tomor Kotorri mendoj që nuk ka pse të diskutohet pasi nuk ka diçka që nuk është në dobi të komunës që mos ta qoj përpara apo ta pranojë këtë kërkesë nga kryetari.

Rasim Fazliu – Edhe ne pajtohemi me propozimin e kryetarit që z. Tomor Kotorri të shpallet qytetar nderi nga Komuna e Rahovecit edhe siç e tha parafolësja ne edhe ashtu jemi të binjakëzuar dhe kemi shumë raporte të mira miqësore me komunën e Përmetit, kështu që e mbështesim këtë iniciativë të Kryetarit dhe mendojmë se është e qëlluar.

Dervish Çadraku – Sigurisht që pajtohemi edhe është shume veprim i mirë, kemi edhe raste tjera këto vëllazërimi dhe këto merita u jepen njerëzve që japin kontribut në lidhje me çështjen edhe të bashkëveprimeve të përbashkëta të Kosovës dhe sidomos Shqipërisë por unë kam një vërejtje pasi kjo po mbaron me kaq, pasi po i japim një vlerë e bëjmë një binjakëzim edhe pastaj mbaron me kaq. Ne kemi disa binjakëzime duke filluar prej Kukësit që vazhdojnë raportet por nuk kemi bashkëpunim pasi për një arsye e kemi bërë binjakëzimin si me Vlorën, Përmetin, Kukësin mirëpo nuk ka veprime konkrete mes vete që me veprua dhe me komunikua. Prandaj unë këtë vërejtje që të merret parasysh që të vazhdojmë edhe me komunikime ekonomike, kulturore, artistike, turistike dhe jo vetëm kaq me përfundua vetëm me një mirënjohje.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Çadraku, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvendë pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i vendimit për caktimin e komisionit ad-hoc për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Të nderuar kolegë kuvendarë, siç e dini edhe me herët z. Esat Haxhijaha ka qenë anëtar i Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, por ai nuk është më pasi ka nderuar jetë, prandaj sipas ligjit duhet të zëvendësojmë me një anëtar tjetër. Ne duhet të formojmë një komision ku 2 anëtar do të jenë nga kuvendi dhe 3 nga fshati Hoçë e Madhe, pastaj duhet të shpallet ftesë publike ku do të konkurrojnë qytetarët e ndryshëm. Pas përzgjedhjes nga ana e këtij komisioni neve si Kuvend na vinë emrat për ti votuar.

Rasim Fazliu – I nderuari kryesues këtë anëtar e përzgjedh komisioni apo Kuvendi, sepse në vendim është cekur se ky përzgjidhet nga komisioni.

Kryesuesi – I nderuar komisioni i përzgjedhë emrat të cilët i kanë plotësuar kushtet, kurse Kuvendi vendos se cili duhet të jetë anëtar pas votimit nga ana e tyre. Konstatohet se edhe pika e pestë kalon për Kuvend, kalojmë në pikën e radhës:

6. Raporti i Performancës Komunale janar – dhjetor 2019.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Dallimi ndërmjet këtij raporti dhe raportit të vitit të kaluar kanë tregues ose në fusha, më herët i kishim 14 fusha kurse tani i kemi 19 fusha, fusha të ndryshme janë shërbimet publike, administrative, përgjegjshmëri komunale, transparencë, parkingje publike, barazia gjinore pastaj barazia gjinore edhe tek punësimi, hapësirat publike e shumë fusha tjera. Nuk dua të zgjatem me shumë pasi nëse ju dëshironi unë mundem edhe me lexua raportin por aty janë të paraqitura në përqindje për çdo tregues që është dhe a është i mirë sigurisht që unë pajtohem që është i mirë por gjithsesi ka nevojë edhe për plotësime d.m.th. ka nevojë ende shumë punë me u bo por kur e marrim raportin e performancës edhe puna që është bërë edhe prej këtij grupi edhe prej ekzekutivit gjithashtu edhe prej kuvendit sigurisht që jemi të kënaqur pasi jemi të radhitur në vendin e dytë në nivele të Kosovës. Ne presim që të fitojmë grande edhe për vitin tjetër dhe sigurisht që ky grand do të shkojë në interesin e qytetarëve sa i takon investimeve publike aty ku e shohim ne me interes dhe më të nevojshme për të investuar.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar, gjithsesi ky është një rezultat dhe një e arritur dhe tani po dua të uroj edhe drejtorin e Financave por gjithashtu me falënderua edhe kontributin e Kuvendit dhe gjithë akterëve që komuna jonë për këtë vit është në vendin e dytë në nivele të Kosovës dhe shpresoj që vitin tjetër të jemi të parët.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, unë dua të të bëj disa ndërhyrje kur jemi te raporti i performancës komunale janar-dhjetor 2019. E kam vërejtur se askund nuk shkruan Komuna e Rahovecit në këtë dokument dhe sikur ta sheh ndonjë qytetar këtë dokument nuk e din se për cilën komunë flitet, pasi nuk është as në fillim dhe as në fund. Në fund ceket Koordinatorë për performancë Biondina Rama-Fazliu. Pra duhet të ceket diku Rahovec, pra të dihet adresa e këtij dokumenti. Sa i përket raportit, neve po na vjen mirë që komuna jonë është renditur si e dyta në nivel të Kosovës dhe që ka grandin në bazë të kësaj performace. Unë e kam analizuar në hollësi dhe e kam parë që në disa fusha komuna qëndron shumë mirë, në disa qëndron dobët por komuna sigurisht duhet të angazhohet në këto fusha ku qëndron dobët me investua më tepër dhe herën tjetër të jetë edhe aty mirë pasi mundet që viteve të ardhshme të avancojnë edhe komuna tjera dhe me këtë përqindje komuna jonë me mbet mbrapa. Pastaj rreth sqarimit se si bëhet ky raport, pasi kryesuesi e din që ne kemi një trajnim për raportin e performancës, sistemin e menaxhimit të raportit të performancës dhe në fakt unë e kam vërejt edhe po e shoh edhe tash ndër delegatët se pak e kemi kuptuar për raportin e performancës edhe si bëhet edhe çfarë rëndësi ka, edhe ne jemi trajnuar vetëm në një modul që i kemi edhe modulet tjera që sigurisht do të mësojmë edhe më shumë edhe pse kisha kërkuar që anëtarët e KPF-së të marrin pjesë pasi është mjaftë e dobishme për neve që po ashtu është edhe në interesin e komunës kur ne japim kontributin tonë në këtë drejtim. Mirëpo kjo tash raportin që kemi përpara neve, po del që është raport i përgatitur nga koordinatorja d.m.th. ato shënime dhe të dhëna që i ka dhënë ajo por nuk është raporti i Ministrisë së Pushtetit Lokal, d.m.th. se a ka raport kthyes se këto informata që i keni dorëzua ju në një fushë 100% por a ka pasur verifikim që edhe ata me me pranua këtë që vërtet këtu Komuna e Rahovecit qëndron 100% ashtu që është raportua. Sa për sqarim edhe me të mirë tek fusha 11, parkingjet publike. Kjo është për me qartësua dhe me kuptua më mirë, ku thotë tek formulari 1.1.1, numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komunë, vlera e përqindjes që e kemi raportuar është 71%. Në raport me çka është raportua ky 71% p.sh. a është raportuar në raport me numrin e vendbanimeve, në kokë banori pasi nuk e kam të qartë, pra si e keni konstatuar se keni parkingje 71% kur unë e di që Rahoveci nuk ka edhe aq shumë parkingje dhe ne kemi nevojë për parkingje ose tek formulari 11.1.2 numri i vet parkimeve publike në krahasim me numrin e veturave të cilat kanë regjistrim të vlefshëm, vlera e përqindjes të cilën e keni raportua është 100%. A është e vërtetë që qytetarët e Rahovecit të gjithë sa kanë vetura kanë të gjithë vend për parkim. Pra pikërisht këtu po e dua formën e raportimit në raport me çka, edhe pse kjo pika e dytë po del që është ne raport me numrin e veturave e saktëson që janë të regjistruar mirëpo sa është kjo reale nuk e di, edhe te këto tjerat po me intereson forma e zgjedhjes së përqindjes sikurse kjo pak më herët që thash në raport me çka zgjidhet përqindja.

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, është fakt se performanca ka një rol të madh e cek edhe më herët një trajnim që ka filluar përmes performancës që bëhet nga kryetari e drejtoritë atëherë edhe fitohen edhe grande ku qytetarët kanë edhe përfitime mirëpo qasja që edhe atë ditë e thash ne takim që disa kolegë tanë të Komitetit për Politikë dhe Financa në pamundësi që me hy ne atë trajnim pasi tani trajnimet po bëhen online pasi po ka vështirësi në kyçe mirëpo ata që kanë mundësi do të ishte mirë me marr qasje.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë vetëm po dua me ja urua qeverisjes komunale që ka zënë vendin e dytë për performancë në nivele të Kosovës dhe uroj që vitin tjetër edhe vendin e parë të dalim si komunë e Rahovecit. Kisha një pyetje konkrete pasi edhe auditori i përgjithshëm na ka dhënë vërejtje për E-kioskun ndër vite që nuk është bërë dhe ne e bëmë E-kioskën dhe pyetja inje është se a po shfrytëzohet kjo dhe a po din qytetarët me përdorë dhe sa është funksionale.


Fatmir Iska – Ky raport nuk është i publikuar në webfaqe por ai raporti i MAPL-së, d.m.th. ky është raport i brendshëm i koordinatores ose kryesueses së grupit. Edhe si e kam lexuar nuk e kuptoj ato vlerat e përqindjes në formula apo pjesëtime, me numër të banorëve apo metër katror pra është krejt një raport tjetër. Edhe në Kuvend do të jetë kryesuesja e grupit që ka punuar me grupe të caktuara nëpër drejtori në fusha të caktuara, pra përgjigjet më të sakta dhe më të detajuara mundet me na dhanë kryesuesja e grupit për performancë, A ka mbikëqyrje kjo, unë mendoj se absolutisht që po si një lloj auditimi pasi ti mundesh me i dhanë të gjitha shifrat 100% dhe me qenë fitues i grandit ose me dal në vendin e parë por ato kalkulohen saktë që nga formulat tregojnë që koeficienti e tregon saktë edhe pastaj që të gjitha mblidhen dhe krijohet totali e përcakton finalizimin, d.m.th. kjo mbikëqyrje ka ardhë deri te prodhimi i vendit të dytë dhe për më saktë të gjitha informatat kemi me i pasë në mbledhje të Kuvendit prej kryesueses së grupit e cila ka punuar ngushtë me grupin e performancës. Tek E- kiosku shfrytëzohet jo në masën aq sa duhet me u shfrytëzua pasi ka qytetar që din me shfrytëzua mirëpo ka edhe që nuk din dhe për ata që nuk din atëherë janë punëtorët e administratës që kujdesen për këtë, dhe mendoj që kjo duhet të shtrihet edhe në 3-4 pika tjera që me pas mundësi qytetarët me i krye shërbimet.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, konstatojmë se edhe pika e gjashtë kalon për Kuvend. Tani jemi në pikën e shtatë:

7. Të ndryshme.

Të nderuar kolegë kuvendarë, atëherë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj 11:30

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

